

Vendim nr. 249 datë 28.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtar

në datën 28.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (J) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **JANI STRAMARKO**, përfaqësuar nga avokat Aleksandër Muskaj, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 3033, datë 05.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr.1305, datë 16.09.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2023- 3022, datë 12.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 29, pika 2, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është një ndër trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit K.S., i cili së bashku me të ndjerin V.S., kanë qenë përkatësisht djemtë e vëllezërve Stramarko (Jani dhe Jorgji). Këta të fundit pretendohet se kanë pasur në pronësi një pronë në fshatin Gjolekaj në Dhërmi.

2. V.S. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila, me vendimin nr. 691, datë 10.05.2002, ka pranuar kërkesën e tij për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik të pronësisë për sipërfaqen prej 13 ha tokë, të llojit kullotë, në vendin e quajtur “Adhëndri-Dhërmi”, me kufij, veriu-Përroi, jugu-K.Bifsha, lindja-S.Ruçi e F.Janila dhe perëndimi-Goreci e Deti.

3. Pasi ka ndërruar jetë V.S., me kërkesën e djalit të tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 3311, datë 24.12.2008, ka vendosur të lëshojë dëshminë e trashëgimisë ligjore për të.

4. Më pas, me vendimin nr. 1918, datë 27.09.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i ka njohur pronësinë dhe i ka kthyer në natyrë trashëgimtarëve të të ndjerit V.S., një sipërfaqe toke, të llojit kullotë, të ndodhur në vendin e quajtur Faqja e Adhëndrit, me kufij veriu-Përroi, perëndimi-Goreci e Deti, lindja-S.Ruçi e F.Janila, jugu-K.Bifsha, pasi e ka konstatuar si në kundërshtim me ligjin mosnxjerrjen e aktit administrativ nga Agjencia Qendrore e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*vendimi nr. 1918/2010*). Ai vendim, pasi ka marrë formë të prerë, është regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Në vijim, rezulton se trashëgimtarët e V.S. kanë tjetërsuar një pjesë të kësaj pasurie të paluajtshme të njohur e të kthyer si pasuri trashëgimore te një palë e tretë. Edhe ky ndryshim është pasqyruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

5. Në këto kushte, kërkuesi dhe paditësit e tjerë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të K.S., ky i fundit, gjithashtu, trashëgimtar ligjor i njërit prej vëllezërve Stramarko, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi, duke kërkuar: (i) detyrimin e të paditurve për t’i njohur si trashëgimtarë dhe pronarë për pjesën takuese të pasurisë së trashëgimlënësit të tyre për pronën të ndodhur në vendin e quajtur Faqja e Adhëndrit, me kufijtë e përcaktuar në vendimin nr. 1918/2010; (ii) detyrimin e të paditurve për t’u kthyer dhe dorëzuar atyre pasurinë trashëgimore, pasurinë e fituar nëpërmjet saj dhe posedimin e sendeve të fituara si trashëgimtarë të V.S.; (iii) sigurimin e padisë nëpërmjet pezullimit të veprimeve në regjistrin e pasurive të paluajtshme në lidhje me pasurinë objekt gjykimi.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 3033, datë 05.11.2012, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova, duke argumentuar se paditësit nuk arritën të provonin cilësinë si ish-pronarë të trashëgimlënësit të tyre K.S., pasi e vetmja provë që kanë paraqitur për të vërtetuar pretendimet e tyre ishte një fletë e Fletores Zyrtare të vitit

1939. Me anë të saj pothuajse provohet, sipas gjykatës, se vëllezërit Stramarko kanë pasur një pronë në fshatin Gjolekaj në Dhërmi. Ajo gjykatë ka vlerësuar se vetëm koincidenca e vendndodhjes në të njëjtin fshat ishte e pamjaftueshme objektivist të provonte pretendimin e paditësve për pronësinë në lidhje pronën objekt gjykimi. Rrjedhimisht, edhe pretendimi i ndërlidhur për pavlefshmërinë e kontratave të realizuara ndërmjet të paditurve dhe personave të tretë blerës është vlerësuar i pabazuar në ligj e në prova dhe është rrëzuar.

7. Në bazë të ankimit të kërkuarit dhe paditësve të tjerë, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1548, datë 30.10.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Arsyetimi i asaj gjykate është në të njëjtën linjë me vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

8. Rekursi i paraqitur nga kërkuari dhe paditësit e tjerë nuk është pranuar për shqyrtim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2023-3022, datë 12.07.2023, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, pasi gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë dhe se vendimet e tyre nuk ishin në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 19.08.2024 kërkuari, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 19.09.2024.

II

Pretendimet e kërkuarit

10. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë kishte detyrimin që ta shqyrtonte rekursin me ligjin e kohës kur ishte paraqitur ai dhe jo me ligjin e kohës kur ishte marrë në shqyrtim nga ajo gjykatë.

10.2. *Së drejtës për t'u mbrojtur*, pasi gjykatat e faktit nuk i kanë çmuar të gjitha provat e administruara në dosjen gjyqësore. Fletorja Zyrtare e vitit 1939 provon se prona fillimisht ka qenë në pronësi të vëllezërve Stramarko, ndërsa gjatë gjykimit u provua dhe se cilët ishin vëllezërit Stramarko dhe trashëgimtarët e tyre. Gjithashtu, pavarësisht faktit se gjatë gjykimit u provua se pasuria e pretenduar nga kërkuari ishte identike me pasurinë e njohur me vendimin nr. 1918/2010, ajo gjykatë, në bazë të parimit *iuria novit curia*, mund të kishte caktuar kryesisht një ekspert të fushës për të parë përputhshmërinë midis tyre. Për shkak të këtij mosveprimi, ajo

gjykatë nuk ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, për rrjedhojë ka cenuar edhe të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe parimin e ligjshmërisë. Pavarësisht se provat që janë paraqitur nga të paditurit dhe paditësit në procese të ndryshme gjyqësore me qëllim vërtetimin e pronësisë për pronën objekt mosmarrëveshjeje kanë qenë të njëjta, njëres palë i është njohur pronësia për të, ndërsa palës tjetër jo.

- 10.3. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi vendimi i gjykatës së apelit nuk i përmbush standardet kushtetuese të një vendimi të arsyetuar, sepse është një përsëritje “*mot-a-mot*” i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërkohë që parashtrimi i fakteve në një gjykatë më të lartë ka për qëllim rivendosjen në vend të së drejtës, duke rikontrolluar vendimin e gjykatës më të ulët. Ndërsa vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i përmbahet asnjërit prej elementeve të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese për vendimin e arsyetuar. Ai vendim, jo vetëm që nuk përmbush kriteret e vendimit të drejtë dhe logjik, por në të mungon referimi dhe analiza e ligjit të zbatueshëm, si dhe pjesa përshkruese arsyetuese. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk është njohur me shkaqet e mospranimit të rekursit, duke u vënë në kushtet për të mos ushtruar një ankim kushtetues individual efektiv.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

13. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës. Lidhur me këtë kriter, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për pasojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

14. Për sa i takon kriterit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 12.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 19.10.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 19.08.2024, pra pas 10 muajve. Kërkuesi ka pretenduar se ka marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 24.04.2024, kur ai është paraqitur për të marrë informacion pranë asaj gjykate, e cila, sipas tij, nuk e ka njoftuar individualisht atë për vendimin. Madje, ai pretendon se ajo gjykatë nuk e ka njoftuar as për datën dhe orën e seancës.

16. Referuar standardeve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese dhe dokumentacionit në dosje, Kolegji konstaton se vendimi nr. 00-2023-3022, datë 12.07.2023 i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 19.10.2023, ndaj dhe Kolegji vlerëson, duke pasur parasysh për sa më lart, se kërkuesi ka marrë njoftim për vendimin kur ai është publikuar në faqen zyrtare dhe është bërë i disponueshëm për palët. Për më tepër, Kolegji mban në konsideratë se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje nga vetë kërkuesi me paraqitjen e rekursit, nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tij, ndaj ai kishte interesin dhe mundësitë për të ndjekur fatin e ankimit të tij. Kolegji konstaton,

gjithashtu, se në rekursin e paraqitur bashkëlidhur kërkesës nuk rezulton që avokati i kërkuarit të jetë kujdesur për të shënuar të dhënat elektronike të kontaktit, me qëllim realizimin e njoftimeve nga sekretaria e asaj gjykate, çka do të mundësonte njoftimin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Nga ana tjetër, argumenti i kërkuarit se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë në kohën kur është interesuar pranë asaj gjykate për çështjen e tij, nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të provuar momentin e konstatimit të cenimit, për sa kohë që një informacion i tillë mund të kërkohet në çdo rast dhe në çdo kohë kur një palë ndërgjyqëse kërkon të pajiset me një kopje të vendimit gjyqësor.

17. Për sa më lart, Kolegji konstaton se ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë jashtë afatit ligjor 4-mujor, ndaj kriteri paraprak për legjitimitimin *ratione temporis* nuk plotësohet. Në këto kushte, analiza e përmbushjes së kriterit *ratione materiae* bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

18. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.